

# KËRKESË PËR OFERTA

Kompania ELKOS SH.P.K fton institucionet shëndetësore publike dhe private që janë të licencuara brenda Republikës së Kosovës, të paraqesin ofertat e tyre për shërbimin e prezëntuar më poshtë.

**Data e njoftimit: 18.10.2023**

**Nr.Protokolli : 1785/23**

**Ky njoftim është përgatitur në gjuhën:**

SHQIPE

## 1 EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Informata për Kompaninë	
<b>Emri Zyrtar</b>	ELKOS SH.P.K
<b>Adresa Postare</b>	Rr. Zahir Pajaziti / Zona Industriale ,30000 Pejë (Objekti ETC Pejë)
<b>Qyteti dhe Vendi</b>	Pejë/Kosovë, 30000
<b>Personi kontaktues</b>	Qendra e Kontaktit Elkos Group-080030300 049 779-490 qek@elkosgroup.com

## 2 LËNDA E TENDERIT

Kompania ELKOS SH.P.K ka filluar procedurat e brendshme për hapje të një tenderi, në të cilën kërkon të marrë shërbime nga një institucion publik shëndetësor ose privat shëndetësor, në mënyrë që të bëjë verifikimin e aftësisë së çdo punonjësi/se të saj për të punuar.

SHËRBIME

Nr.	Përshkrimi	Nr
1	Çertifikata shëndetësore	2800-3000

Lloji i procedurës i ndjekur nga zyra për prokurim në kompaninë ELKOS, për të shpall tenderin në fjalë:

 E HAPUR

Kompania ELKOS do të përzgjedh njërin nga ofertuesit më të mirë dhe pastaj do të ftohet për takim, në mënyrë që të negociohet dhe të nënshkruhet kontrata në formën e saj përfundimtare. Në qoftë se, ka 2 (dy) e më shumë ofertues, në të cilën janë me oferta përafërsisht të njëjta dhe përzgjedhja e njërit është e vështirë, atëherë do të ftohen për negociata të mëtutejshme, në mënyrë që të reduktohet numri i tyre në 1 (një) dhe kështu të bëhet edhe përzgjedhja e fituesit, pas negociatave.

## 2.1 Përshkrimi

Sipas kërkesave ligjore duke u bazuar në Ligjin për siguri dhe shëndet në punë me NR. 04/L-161 Kompania ELKOS kërkon që të gjithë të punësuarit e saj të nënshtrohen kontrollave mjeksore duke i paisur me certifikata shëndetësore për aftësi në punë, me kërkesa shtesë nga kompania, në të cilën do të dëshmohet gjendja e mirë/jo e mirë shëndetësore e punonjësve të saj. Kërkesa për shërbime është në këto fusha:

Çertifikatë shëndetësore – cilësohet si dokument shëndetësor unik, në bazë të cilit vërtetohet gjendja shëndetësore, shkalla e dëmtimit fizik ose psikik dhe shkaku i dëmtimit. Institucionet shëndetësore që lëshojnë certifikata shëndetësore, janë të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private të licencuara, të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me ligj dhe akte nënligjore lidhur me hapësirën, pajisjet dhe personelin e nevojshëm për lëshimin e llojit përkatës të certifikatës.

Institucioni shëndetësor duhet që të përgatis një ofertë të veçantë për certifikat shëndetësore sipas kërkesave të udhëzuesit administrativ e që do të përfshij:

- 1 Analizat laboratorike, sedimentimi i eritorociteve, hemogrami, urina, dhe EKG;
- 2 Ekzanimi nga doktori i mjekësisë ose specialist i mjekësisë familjare.

Përveç kësaj, institucioni shëndetësor duhet që të përgatis një ofertë shtesë, në të cilën duhet t'i bashkangjitet ofertës së parë dhe e cila duhet të përfshij:

1. Analiza shtesë për kontroll të organeve vitale (interno) për të parë në qoftë se punonjësi/ja mund të vuaj nga ndonjë sëmundje kronike dhe
2. Kontrolla neuro-psikiatrike.

- a. **Kushtet e veçanta**-Zyra për prokurim ka vendosur disa kritere, në të cilën institucionet shëndetësore duhet që të përmbushin gjatë procesit të përgatitjes së ofertave të tyre

Institucioni shëndetësor duhet të jetë brenda njërës prej këtyre kategorive:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- Spitalet publike dhe Institutet e Mjekësisë së Punës
- Qendra Klinike Universitare e Kosoves
- Qendrat diagnostike-terapeutike (QDT) me të gjitha lëmitë specialistike, të kërkuara për llojin përkatës të certifikatës, dhe
- Spitalet dhe labororet private

Institucionet shëndetësore që marrin pjesë në këtë tender, duhet që ofertat e tyre origjinale të i dorëzojnë me zarf të mbyllur me anë të shërbimit postar në njësinë qendrore të Elkos Group në Pejë (objekti ETC Peja )

Institucionet shëndetësore private ose publike, që janë përcaktuar për të bërë ofertë, janë përgjegjëse për të dorëzuar ofertat në formë të rregullt (sipas udhëzimeve të këtij njoftimi).

Institucionet shëndetësore, janë përgjegjëse që ofertat e tyre t'i dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar nga kompania ELKOS dhe gjithashtu gjatë orarit zyrtar të punës.

Pjesa e jashtme e zarfit nuk duhet të përmbaj shënime tjera përpos “oferta për shërbime mjekësore”, në mënyrë që të mundësohet një proces sa më kredibil deri në hapje të tyre nga komisioni përkatës për vlerësim.

Ofertuesi duhet që të bashkangjis të gjitha dokumentat e nevojshme, për të mbështetur deklaratimet e tyre në dokument.

- Dokumentat e dorëzuar duhet të jenë kopje
- Dokumentat e dorëzuara nuk do të kthehen operatorëve që nuk kanë fituar në tender.

Institucioni që do të marrë pjesë në tender do të njoftohet me kohë për çdo ndryshim në specifikimet e përshkruara në këtë dokument njoftues. Zyra për prokurim në kompaninë ELKOS, rezervon të drejtën për të kërkuar informacion shtesë ndaj çdo ofertuesi, në të cilën do të marrë pjesë në tender, në qoftë se konsiderohet e nevojshme që të kemi sqarime shtesë nga ofertuesit.

Oferta e vendosur në zarf nga institucioni shëndetësor privat ose publik duhet të përmbajë të gjitha informacionet dhe specifikimet e përshkruara me këtë dokument njoftimi.

- Oferta duhet të përmbaj kopjet e certifikatave të regjistrimit të biznesit
- Oferta duhet të përfshij çmim-in në Euro, për pakon e shërbimeve në përgjithësi dhe për çdo shërbim në veçanti.
- Kompania ELKOS, rezervon të drejtën të refuzoj ndonjë apo të gjitha ofertat e marra.

#### **b. Vendi i dhënies së shërbimit**

Ofertuesi duhet të vizitoj çdo njësi të kompanisë, nga ku punonjësit do të marrin shërbimin mjekësor. Pra, ofertuesi obligohet që të krijoj pika operuese në çdo njësi.

#### **c. Vlera e parashikuar e kontratës**

Komisioni për vlerësim të ofertave do të marrë parasysh ofertën që ka çmim më të ulët për shërbimin e dhënë. Pas selektimit të operatorit, zyra për prokurim do të thërras personat kompetent të operatorit në fjalë për takim. Rezultati i takimit mund të shpie në nënshkrim të kontratës ose refuzim të ofertës.

#### **d. Afatet kohore për përmbushje të kontratës**

Institucionet shëndetësore në ofertat e tyre duhet të përcaktojnë një afat kohor, në të cilën ka mundësi për të përfunduar shërbimin në fjalë, për të gjithë punonjësit. Zyra për prokurim dotë mbikëqyrë procesin e implementimit të këtij projekti dhe në qoftë se vërteton, shkelje të specifikave të kontrates, do të ndëshkohet sipas marrëveshjes finale të përgatitur në fund.

### **3 KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË OFERTIM**

#### **a. Përshtatshmëria profesionale**

Institucioni shëndetësor që do të marrë pjesë në ofertim duhet që të posedoj certifikaten e biznesit me llojin e veprimtarive të regjistruara dhe të bashkangjis një kopje të saj dosjes së përgjithshme. Poashtu, duhet të bashkangjis një kopje të certifikates së numrit fiskal dhe licensën e punës

#### **b. Kapaciteti teknik dhe profesional**

Institucioni shëndetësor duhet që të dëshmoj se ka përfunduar me sukses shërbime të tilla në të kaluarën. Ofertuesi në dosjen e tij duhet që të bashkangjis një certifikatë për standarte të përdorura në dhënie të shërbimit. Gjithashtu, ofertuesi duhet që të dëshmoj për profesionalizmin e mjekëve që do të japin shërbimin e kërkuar. Të gjitha dokumentet duhet të i bashkangjiten dosjes finale të ofertës.

#### **c. Garantim i cilësisë së shërbimit**

Institucioni shëndetësor duhet që të përgatit një raport final për çdo punonjës mbi gjendjen shëndetësore të tij/saj. Këto raporte duhet që të dorëzohen tek Kompania ELKOS. Kompania rezervon të drejtën të mos kryej pagesën për shërbimin në fjalë deri në përmbushje të çdo pike të përcaktuar në kontratë, e nënshkruar në mes të ofertuesit dhe kompanisë ELKOS.

## 4 INFORMACION PLOTËSUES

Më poshtë do të ipen disa informacione të nevojshme për ofertuesit, në të cilën do të shërbej për të informuar ata mbi procedurën që duhet ndjekur në dorëzim të ofertave të tyre. Këto informata mund të ndryshojnë ndërkohë, por zyra për prokurim do të informoj çdo ofertuespasi që është bërë pjesë e ofertimit.

### 4.1 Afati kohor për ofertim:

Zyra e prokurimit në kompaninë ELKOS ka vendosur që koha e fundit për të dorëzuar ofertat është data 27.10.2023, në ora 16:00.

### 4.2 Dorëzimi i ofertës

Ofertuesi duhet që të vendos ofertën e tij në një zarf të mbyllur, duke shënuar në të “oferta për shërbime mjekësor” dhe asnjë informacion tjetër në sipërfaqe të saj. Zarfi mund të dorëzohet fizikisht ose me shërbim postar në Elkos Group -recepioni i njësisë ETC-Peja 1 (Zona Industriale,30000,Pejë )

### 4.3 Takimi për hapje të ofertave

Ofertat do të shqyrtohen nga një komision i ngritur për shqyrtim të ofertave, menjëherë pas përfundimit të afatit kohor të vendosur për ofertim. Hapja e ofertave do të bëhet në prani të strukturave kryesore organizative të kompanisë në lidhje me çështjen, kështu duke bërë procesin sa më transparent dhe njëherit kredibil. Komisioni do të vendos, duke marrë për bazë specifikat e këtij dokumenti.

### 4.4 Kontakti

Të gjitha institucionet shëndetësore që janë të interesuara për të marrë pjesë në tenderim dhe kanë nevojë për informata shtesë, janë të lirë të na kontaktojnë në numrin tonë kontaktues

**0800 30 300 / 049 779-490** ose në email-in zyrtar [qek@elkosgroup.com](mailto:qek@elkosgroup.com)

**Vëmendje!** Kompania ELKOS, nuk do të marrë përgjegjësi që të kompenzoj asnjë shpenzim që institucionet shëndetësore kanë bërë gjatë procesit të përgatitjes së ofertave të tyre, për të marrë pjesë në tenderin e shpallur